# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432356**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Testi PISA 2025, Shqipëria në krye të rajonit, Rama: Dëftesë e jashtëzakonshme, kemi lënë pas edhe di sa vende që sot janë në BE |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/09/testi-pisa-2025-shqiperia-ne-krye-te-rajonit-rama-deftese-e-jashtezakonshme-kemi-lene-pas-edhe-disa-vende-qe-sot-jane-ne-be/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 06:44:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 9 shtator 2026, 06:38:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 9 shtator 2026, 06:37:00 UTC → 9 shtator 2026, 06:39:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e928b4198dd89dd51ebc274d858f036a745bb6f9c1bcbc0e669c7c8fc8db59f2` |
| TEKSTI | `273aaceaf24e72bdd6b246b7679739046d063c2084d46fc22ada02b630fe6a15` |
| PAMJA | `78b4c71dc485837c0808f4db401a1486fbed5e26c8e1a56e24dc12330d1bfd0b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `df4f74ccd6a88d9814a4e581016c0026d92a08b5c9075b055dcc3036141dbf2f` |
| E MËPARSHMJA | `33efcde1c21b917fd69b251f218b9a3a1f89fc9c309054dc99e99bd72d53bc8b` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/df4f74ccd6a88d9814a4e581016c0026d92a08b5c9075b055dcc3036141dbf2f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Testi PISA 2025, Shqipëria në krye të rajonit, Rama: Dëftesë e jashtëzakonshme, kemi lënë pas edhe disa vende që sot janë në BE

09/09/2026 08:38

Kryeministri Edi Rama ka reaguar për rezultatet e Shqipërisë në testin ndërkombëtar PISA 2025, duke i cilësuar ato si një "dëftesë të jashtëzakonshme" për vendin.

Në një transmetim live në Facebook, Rama vlerësoi përmirësimin e ndjeshëm të nxënësve shqiptarë në matematikë, shkencë dhe lexim, duke theksuar se Shqipëria tashmë renditet e para në rajon në disa prej këtyre fushave. Rama u shpreh se ky rezultat është një vlerësim jo vetëm për qeverinë dhe Ministrinë e Arsimit, por edhe për mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe nxënësit.

*"Mirëmëngjesi! Ka ditë që shkohet në punë me ndjesinë që kjo është detyra. Ka ditë që shkohet në punë me ndonjë mendim që e përcakton atë ditë si rezultat i një çështjeje që është në tryezë dhe ka ditë si kjo që shkohet në punë me një kënaqësi shumë të madhe, por shumë të madhe. Sepse dje kemi marrë një rezultat, një dëftesë për të cilën kemi punuar shumë fort dhe jo një e dy ditë, po kemi punuar shumë fort për një vit të tërë për të adresuar realisht aty ku duhej të gjitha pikat e nevojshme.*

*Shqipëria dje ka marrë një dëftesë të jashtëzakonshme, sepse është një dëftesë që i takon atyre që janë drita e syve të prindërve të këtij vendi, nxënësve tanë. Kemi dalë si asnjëherë më mirë në testin PISA 2025, një test i cili përcakton nivelin e të nxënit për fëmijët e arsimit parauniversitar në matematikë, shkencë dhe lexim. Dhe jo vetëm kemi bërë një përparim të jashtëzakonshëm pas atij momenti çoroditjeje që shkaktoi Covidi, edhe ku të gjitha vendet në fakt ranë dhe ne patëm një rënie të ndjeshme, e cila, si të thuash, na dha një shuplakë pas një periudhe të mëparshme rritjeje të butë, por konstante dhe sot jemi faktikisht të parët në rajon. Të parët në rajon, duke zënë vendin që kemi ambicie të zëmë në çdo drejtim dhe në çdo sektor, por që në këtë rast i bën një nder shumë të madh, një nder shumë të madh jo qeverisë thjesht, por i bën një nder shumë të madh në radhë të parë të gjithë atyre që kanë në duar fëmijët tanë.*

*I bën një nder shumë të madh edhe drejtuesve të shkollave, natyrisht gjithmonë pas mësuesve. Kemi bërë një punë kolosale milingonash me drejtuesit e shkollave. Shkolla e drejtorëve është një histori e qartë suksesi, i bën një nder shumë të madh patjetër edhe vendit si i tillë, sepse krijon një lehtësi psikologjike edhe për prindërit.*

*Prindërit e mbytur nga balta, prindërit e mbytur nga jargët e gjithfarë lloj vemjesh në kanalet sociale, që nuk lënë orë e minutë pa jashtënxjerrë helm për çdo gjë në këtë vend dhe që natyrisht ngarkojnë psikologjikisht gjithë popullatën.*

*Është një rezultat fantastik edhe është një rezultat inkurajues, i jashtëzakonshëm. Është një rezultat që flet për punën shumë të mirë të bërë edhe nga Ministria e Arsimit, për punën e bërë nga ministrat e arsimit njëri pas tjetrit dhe ndjehem jashtëzakonisht mirë. Është një histori koti, thotë kjo Eda Merkula. Një histori koti. Një histori koti që Shqipëria del e para në rajon në një test të së ardhmes, në testin për dijet e fëmijëve tanë në shkencë, në matematikë dhe në lexim. Një histori koti.*

*Ajo është merita e atyre nxënësve, thotë kjo tjetra, që e kanë marrë vetë rezultatin. S'ke pse mburresh. Në fakt, jo. Në fakt, jo. Nxënësit kanë pasur historikisht mes tyre ata më të mirët, ata më të*

*dobëtit, por sikur të ishte meritë thjesht dhe vetëm e tyre, nuk do të ndryshonin rezultate. Do ishte gjithmonë po ashtu.*

*Çfarë ke bërë për Shqipërinë, thotë, ke 12 vjet? Urdhëro. Po flas sot, tani për një rezultat fantastik. Një nga ato rezultate që ndërtohen vit pas viti, muaj pas muaji, javë pas jave, ditë pas dite, që nuk bëjnë lajm, që nuk bëjnë zhurmë, që nuk krijojnë kushtet për të ngacmuar vëmendjen tënde në rrjetet sociale bashkë me Fatmirin. Bashkë me Fatmirin që thotë: je bërë qesharak. Patjetër, patjetër. Është shumë qesharake kjo që po them, që Shqipëria ka dalë e para në testin më të rëndësishëm për fëmijët tanë, për nxënësit tanë, testin PISA 2025. E para në rajon. Dakord? Se ne matemi me rajonin në radhë të parë dhe pastaj me të tjerët. Ndërkohë që po ju them dhe tjetrën, që jo vetëm kemi bërë një kërcim të jashtëzakonshëm pikësh, por kemi gjithashtu lënë pas edhe disa vende, disa vende që sot janë në Bashkimin Europian.*

*Dëgjove, Fatmir, se ti qenke insistues në atë marrëzinë tënde. Si po gënjej unë, çfarë po gënjej? Unë po them një të vërtetë që është thënë botërisht dje në shpalljen e rezultateve dhe ti mund të hysh edhe t'i verifikosh, por ti nuk je i interesuar për këtë. Unë e di, edhe s'ke pse je interesuar, sepse ti je i zhytur në helmin e kanaleve sociale dhe më vjen shumë keq. Më vjen shumë keq për ty.*

*Ndërkohë që më vjen shumë mirë për të gjithë mësuesit, më vjen shumë mirë për të gjithë drejtuesit e shkollave, më vjen jashtëzakonisht mirë për prindërit që tanimë kanë një arsye të marrin frymë lirisht pas gjithë torturës që heqin në këto kanalet sociale, ku çfarë nuk dëgjojnë e çfarë nuk shohin e çfarë nuk u thuhet për fatin e fëmijëve në këtë vend, i cili më të mirën e ka vetëm përpara dhe i cili është një vend që përparon çdo ditë, duan s'duan ata që s'duan. Tani mbërrita, vazhdojmë punën"*, shprehet Rama në transmetimin live në "Facebook".

**Top Channel**

Kryesore »
Tre të plagosurit në shpërthimin e karburantit në zonën e Brrylit po trajtohen në Spitalin e Traumës, ministria zbulon gjendjen e tyre shëndetësore
09/09 08:51
SHBA i mbyll derën mallrave kanadeze, Trump ndalon alkoolin dhe motoçikletat
09/09 08:31
VIDEO/ Tre punonjës të plagosur dhe karburanti i gjithi i shkatërruar, detajet e incidentit që tronditi kryeqytetin. Reagon policia
09/09 08:12
"Krisje" mes Trump dhe Netanyahut, SHBA lejojnë sanksionet ndaj kolonive izraelite
09/09 07:41
Shpërthim i fuqishëm në një karburant në zonën e Brrylit, mbeten të plagosur punonjësit. Banorët dalin në rrugë të alarmuar
09/09 07:24
SHBA godet pesë cisterna iraniane, Irani kundërpërgjigjet me raketa drejt një baze amerikane në Jordani
09/09 07:21
Politikë »
Nderimet për Ratko Mladić në Serbi, Ministri Hoxha: Glorifikimi i kriminelëve të luftës bie ndesh me vlerat evropiane
08/09 21:09
Fotolajm/ Nga pamja e re e Zegjinesë te reagimi epik i Nufit, çfarë nuk u pa sot në Kuvend
08/09 20:06
"O hajdute"/ Incidenti para hyrjes në Parlament, reagon Iris Luarasi: Më akuzuan se nuk mbroj gratë, këtë rast do e denoncoj
08/09 19:44
Deklaratat e Ahmetajt për trafikun e armëve, reagon Berisha: Megaskandal ndërkombëtar, rast i paprecedentë në botë
08/09 18:35
Me 79 vota pro, Klodiana Spahiu merr zyrtarisht rolin e ministres së Shëndetësisë
08/09 18:05
Nis votimi në Kuvend, deputetët e PD-së braktisin sallën
08/09 18:03
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top Channel/ Shpërthimi në pikën e karburantit te "Brryli", policia dhe zjarrfikëset në vendngjarje
Top Channel/ Shpërthimi në pikën e karburantit në Tiranë, shembet ndërtesa. Çfarë mbeti pas
Top Channel/ Tiranë, pamje ekskluzive nga shpërthimi në pikën e karburantit, 3 punëtorë të plagosur
Top Channel/ Vezë me bigerina, shishe uji dhe tensione! Çfarë ndodhi në protestën pranë Kuvendit
Top Channel/ Trafiku i drogës, gjykata lë 15 persona në burg
Top Channel/ Tension në protestë, mbi 15 të shoqëruar nga policia
Kryesore
VIDEO/ Tre punonjës të plagosur dhe karburanti i gjithi i shkatërruar, detajet e incidentit që tronditi kryeqytetin. Reagon policia
08:12
Fotolajm/ Nga pamja e re e Zegjinesë te reagimi epik i Nufit, çfarë nuk u pa sot në Kuvend
20:06
Përshkallëzon tubimi, protestuesit godasin me vezë dhe shishe uji makinën e deputetes së PS. Njëri prej tyre i thyen edhe pasqyrën e automjetit

18:32
Ftesë në 5/ Senera Hoxha: Me tradhtinë nuk bëj kompromis, jam luftëtare
19:15
Nga Kane e Yamal te Rodri dhe Messi, publikohet lista me 30 kandidatët për Topin e Artë 2026/ Shumë emra surprizë, por mungon Raphinha
16:40
Më të lexuarat
Do blinte toka në Shqipëri dhe u zhduk në Greqi, gjendet e copëtuar pasaporta e kinezes
Ish-banori i BBV rrëfen për 'Shqipëria Live' betejën me sëmundjen e rëndë: Mendova më të keqen, u mbylla në dhomë dhe…
Fotolajm/ Nga pamja e re e Zegjinesë te reagimi epik i Nufit, çfarë nuk u pa sot në Kuvend
Dokumentacionet e pronësisë në Palasë, Kadastra paralajmëron: Nga nesër nis kontrolli derë më derë
Top Channel sjell surprizën e madhe, Igli Tare bëhet analist i Champions League
Të shtëna me armë zjarri në Laprakë, mbeten të plagosur dy persona. Reagon Policia
Shpërthim i fuqishëm në një karburant në zonën e Brrylit, mbeten të plagosur punonjësit. Banorët dalin në rrugë të alarmuar
"O hajdute"/ Incidenti para hyrjes në Parlament, reagon Iris Luarasi: Më akuzuan se nuk mbroj gratë, këtë rast do e denoncoj
Izraeli i përgjigjet sanksioneve nga Mbretëria e Bashkuar, mbyll konsullatën britanike në Tel Aviv
LIVE/ Një orë seancë mes vezëve dhe përplasjeve të forta jashtë Parlamentit, protestuesit bllokojnë rrugët, policia i arreston, pranga edhe Lapajt

- Lajme
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

- Bota
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

- Sport
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

- Pop News
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

- Programe
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

- Top Channel
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.